



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 315, Datë 06.11.2023

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 219, DATË 20.12.2019,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO POWER PANARITI” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA HEC “VILE”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 1994 KW, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1927/8 prot., datë 03.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 219, datë 20.12.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë “HYDRO POWER PANARITI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vile” me kapacitet të instaluar 1994 kW, i ndryshuar”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 219, datë 20.12.2019, i ndryshuar me vendimin nr. 191, datë 20.11.2020 ka vendosur të licencojë shoqërinë “HYDRO POWER PANARIT” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vile”, me fuqi 1994 kW, për një afat 30-vjeçar me kusht që shoqëria të depozitojë në ERE, lejen e Ujit të rinovuar jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së lejes, në datën 11.05.2022.
- ERE i'u drejtua shoqërisë me shkresën nr. 300 prot., datë 23.02.2022 duke i kujtuar detyrimin për të depozituar lejen e përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor brenda datës 11.05.2022.
- Me shkresën me nr. 844 prot., datë 26.05.2022, ERE i'u drejtua shoqërisë për t'i rikujtuar detyrimin për depozitim e lejes së rinovuar nëse është pajisur me të, nëse jo, të informojë mbi statusin e aplikimit aktual të shoqëruar me dokumentin përkatës.
- Shoqëria në përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 844/1 prot., datë 01.06.2022 ka depozituar aplikimin e bërë pranë AMBU-së në datën 23.03.2022 për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergje nga hec “Vile”,

bashkëlidhur dhe shkresën e AMBU-së me datë 13.04.2022 ku janë konstatuar se tek Hec “Vile” nuk janë instaluar stacioni hidrologjik pranë veprës së marrjes dhe stacioni metrologjik pranë godinës së centralit, shoqërisë i është lënë detyrë nga AMBU që t’i instalojë dhe të riaplikojë brenda 15 ditëve punë.

- ERE i është drejtuar AMBU-së me shkresat (nr.1833/4 prot., datë 12.12.2022, nr.138 prot., datë 16.01.2023) duke i kërkuar informacion mbi statusin e aplikimit të disa shoqërive që kanë qenë në proces rinovimi ndër to edhe për shoqërinë “HYDRO POWER PANARITI” sh.p.k. AMBU me shkresat e depozituara në ERE (nr. 1835/5 prot., datë 29.12.2022, nr.138/1 prot., datë 26.01.2023) ka informuar se aplikimi për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor për Hec “Vile” nga subjekti “HYDRO POWER PANARITI” sh.p.k. është regjistruar në sistem në datën 22.10.2022 dhe është refuzuar në datën 05.01.2023 për mos plotësim të dokumentacionit të nevojshëm.
- Në vijim të korrespondencës të mbajtur me AMBU-në me shkresën e depozituar në ERE me nr. 1928/3 prot., datë 18.10.2023, AMBU ka konfirmuar se shoqëria “HYDRO POWER PANARITI” sh.p.k., ka aplikuar në sistem elektronik për pajisje me leje përdorimi të burimit ujqor dhe leja është miratuar nga Këshilli i Basenit Ujqor Seman në mbledhjen e datës 5.10.2023. Leja bëhet aktive pasi të jenë kryer procedurat administrative të dhënies dhe regjistrimin e saj, si edhe pagesa e tarifave respektive nga ana e shoqërisë.
- Sa më sipër cituar për të vijuar me rishikimin e vendimit të bordit, ERE i’u drejtua shoqërisë me shkresën me nr. 1928/4 prot., datë 26.10.2023 me kërkesën për të depozituar lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor pasi të jenë kryer procedurat administrative dhe leja të jetë bërë aktive.
- Shoqëria me shkresën me nr.1928/6 prot., datë 30.10.2023 ka depozituar lejen e përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor me nr. Serie 000132, nr. 1042 prot., datë 10.10.2023, të miratuar me vendimin nr. 27, datë 05.10.2023, të Këshillit të Basenit Ujqor Seman për përdorim të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik nga Hec “Vile”, me afat një 5-vjeçar, me afat vlefshmërie deri më 05.10.2028.
- Me depozitimin e këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 219, datë 20.12.2019, i ndryshuar me vendimin nr. 191, datë 20.11.2020, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe po ashtu, i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kushtin shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergje nga Hec “Vile” brenda datës 05.10.2028.
- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 219, datë 20.12.2019, i ndryshuar me vendimin nr.191, datë 20.11.2020, ndryshon dhe bëhet:

2. Shoqëria “HYDROPOWER PANARITI” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Vile” brenda datës 05.10.2028.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI